

Data 12.11.2024

**PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall**

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE  
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

*(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)*

OBJEKTI I PROCEDURËS: **Blerje peleti per shkollen H.Nela dhe Cerdhen Nr.2**

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): **03413000-8**

VLERA E FONDIT LIMIT: **4,086,667** (kater milion e tetedhete e gjashte mije e gjashteqind e gjashtedhete e shtate) Lek pa Tvsh.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Bashkia Kukes, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

**I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Sigurim oferte, sipas Shtojcës 4: **81,733.34**(tetedhete e njemije e shtateqind e tridhete e tre pike tridhete e kater)Lek pa Tvsh.

b. *Formulari përmbledhës i vetdeklarimit*

**Rekomandimi Nr. 1797/1 Prot., dt. 10.03.2022 ”Rekomandim mbi hartimin e kriterëve per kualifikim per procedurat e prokurimit per mallra, pune, sherbime(i ndryshuar).**

**Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”(i ndryshuar).

**2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:**

a. Sigurim oferte, sipas Shtojcës 4.

b. *Formulari përmbledhës i vetdeklarimit 9*

**2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:**

- Operoret ekonomik pjesemarrës në këtë prokurim duhet që të plotesojnë kapacitet ligjore, teknike dhe profesionale për kryerjen e këtij prokurimi.

Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

a) licencat profesionale për prodhimin dhe ose furnizimin e mallrave, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe /ose

b) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj;dhe/ose

c) fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose

ç) mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

**Rekomandimi Nr. 1797/1 Prot., dt. 10.03.2022 ”Rekomandim mbi hartimin e kriterëve per kualifikim per procedurat e prokurimit per mallra, pune, sherbime(i ndryshuar).**

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 40, pika 5, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik"(i ndryshuar),.....

(Shënim: *përcaktoni nëse është rasti, aktin konkret ligjor ose nënligjor që parashikon plotësimin e ndonjë kërkesë specifike për ushtrimin e veprimtarisë profesionale që lidhet me objektin e prokurimit).*

## **2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

Per te provuar kapacitetet ekonomike dhe financiare te OE ,AK kerkon qe te paraqiten:

a. Vërtetim nga Administrata Tatimore për xhiron mesatare vjetore per tre vitet 2021, 2022 dhe 2023 në çdo rast, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor vlera e kërkuar duhet të jetë me një vlerë jo me te vogël se 40% te vleres se parashikuar te Kontrates.

b.Kopje e vertetuar te bilanceve te tre viteve te fundit (2021, 2022 dhe 2023) te paraqitur prane Administrates Tatimore te konfirmuar nga ky autoritet. Bazuar ne nenin 43, pika 4, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, i ndryshuar, ...kerkesa konsiderohet e permbushur nese ne bilancet e kerkuara nuk ka raport negativ ndermjet aktivitet dhe pasivitet.

c.Vertetim te leshuar nga autoritetet vendore, për shlyerjen e taksave vendore te parashikuara per vitin 2023 ose per vitin 2024(ne baze te ndonje marreveshje shlyerje me keste te OE per vitin kalendarik 2024)

*Per plotesimin e kriterit te mesiperme te pikes eshte e mjaftueshme paraqitja e deklarates, sipas shtojcës nr.9 (Formulari permbledhës i vetedeklarimit)*

## **Rekomandimi Nr. 1797/1 Prot., dt. 10.03.2022 "Rekomandim mbi hartimin e kriterëve per kualifikim per procedurat e prokurimit per mallra, pune, shërbime(i ndryshuar).**

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, tëVKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik"(i ndryshuar).

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Nisur nga vlera e xhiros vjetore qe deklarohet nje subjekt ekonomik, varet kapaciteti financiar i tij i cili perkthehet ne kapacitet per te realizuar kontraten objekt prokurimi.

**Shënim:** Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohej, autoritetet/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar\ Ligji Nr.9920, datë 19.5.2008 për procedurat tatimore në republikën e shqipërisë i ndryshuar.

(Shënim: citoni dispozitën përkatëse të legjislacionit tatimor, ku përcaktohen afatet për paraqitjen nga tatimpaguesit të deklaratës vjetore pranë organeve tatimore).

Neni 29, Cdo tatimpagues pergatit deklaraten vjetore te te ardhurave te tatueshme ne formen e percaktuar ne udhezimin e Ministrit te Financave ne zbatim te ketij ligji.Tatimpaguesit paraqesin deklaraten vjetore ne organet tatimore brenda dates 31 mars te vitit pasardhes.

---

*Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohej, autoritetet/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi.*

Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitet dhe pasivitet, të shoqëruara me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabel te Autorizuar, vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të VKM nr.285,date 19.05.2021,neni 43,pika 4(*shëno bazën ligjore*), ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitet dhe pasivitet.

**Rekomandimi Nr. 1797/1 Prot., dt. 10.03.2022 "Rekomandim mbi hartimin e kritereve per kualifikim per procedurat e prokurimit per mallra, pune, sherbime(i ndryshuar).**

**Argumentimi:**Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik"(i ndryshuar). Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, igjit nr.25/2018 "Per kontabilitetin dhe pasqyrat financiare"

*(Shënim:citoni dispozitën përkatëse të legjislacionit tatimor, ku përcaktohen rastet kur personat juridikë kanë detyrimin që të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga eksperte kontabël ose shoqëri audituese).*

### **2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:**

Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti kontraktor kërkon dëshmi për furnizimet, autoriteti kontraktor kërkon dëshmi për furnizimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tri viteve të fundit. Në çdo rast, vlera e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të vogël se 20% të vlerës së përllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Autoriteti Kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik, kontrata furnizimi ose/dhe fatura tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

- a) Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

**Rekomandimi Nr. 1797/1 Prot., dt. 10.03.2022 "Rekomandim mbi hartimin e kritereve per kualifikim per procedurat e prokurimit per mallra, pune, sherbime(i ndryshuar).**

**Argumentimi:**Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe nenit 40, pika 4 (ose në rastin e procedurave të thjeshtuara në nenin 55, pika 4/b), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik"(i ndryshuar). Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë ne vlerën jo më pak se 20 % (817,333.4)të vlerës së fondit limit,që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

*Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e kontratave të ngjashme që mund të kërkohet, autoritete/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të kontratave të ngjashme brenda këtij marzhi.*

**2.3.1.**Operatori ekonomik duhet te disponoje mjetet dhe pajisjet e nevojshme teknike per realizimin e kontrates. Per kete duhet te paraqese deshmi per mjetet qe ka ne dispozicion apo mund t'i vihen ne dispozicion operatorit ekonomik per transportin e materialit te Peletit:

- a).Ne funksion te zbatimit te kontrates, kerkohet te jene ne dispozicion keto mjete pune:

<b>Nr.</b>	<b>Emertimi</b>	<b>Njesia</b>	<b>Sasia</b>	<b>Gjendja Juridike</b>
<b>1.</b>	Automjet per transportimin e materialit pelet	Copë	2	Pronësi ose me qera

- b).Per te deshmuar kete, operatoret ekonomik duhet te paraqesin dokumentat e meposhtem:

- Per mjetet qe shenohen ne regjistra publike, nese jane ne pronesi, duhet te paraqiten dokumentat qe vertetojne regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi, çertifikaten e kontrollit teknik, policen e sigurimit vjetor te vlefshme pergjate zbatimit te kontrates)

- Per mjetet qe shenohen ne regjistrat publik, nese jane me qera, duhet te paraqiten dokumentacioni qe verteton pronesine e mjetit, kontrata noteriale e qerese e vlefshme per te gjithë periudhen e realizimit te kontrates objekt prokurimi, regjistrimi i mjetit (leja e qarkullimit, çertifikata e kontrollit teknik, polica e sigurimit vjetor te vlefshme)

*Per plotesimin e kriterit te mesiperm te pikes eshte e mjaftueshme paraqitja e deklarates, sipas shtojcës nr.9 (Formulari permbledhes i vetedeklarimit).*

**Rekomandimi Nr. 1797/1 Prot., dt. 10.03.2022 ”Rekomandim mbi hartimin e kriterëve per kualifikim per procedurat e prokurimit per mallra, pune, sherbime(i ndryshuar).**

**Argumentim:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 5/ç, të VKMnr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”(i ndryshuar), me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

**II.Argumentimi i specifikimeve teknike:**

**Përshkrimi i të dhënave teknike të mallrave objekt prokurimi** të përshkruara sa më saktë dhe në mënyrë të plotë, duke krijuar kushte për konkurrim të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve. Kur është e mundur, specifikimet teknike duhet të përcaktohen në mënyrë të tillë që të kuptohen nga personat me aftësi të kufizuara.

*Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për mallin/mallrat objekt prokurimi, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”(i ndryshuar), **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.***

*Kujdes:Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.*